

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN

#### “PËR

#### **DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.12/2018 “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAVE NË MINISTRINË E BRENDSHME”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është të japë një kontribut real për afirmimin e punonjësve profesionistë dhe me integritet të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nëpërmjet zbatimit të parimit të integritetit, rritjes profesionale dhe garantimit të një karriere të drejtë dhe të bazuar në meritokraci, duke krijuar në vazhdimësi institucione të forta dhe të besueshme.

Arritja e këtij qëllimi synohet të realizohet nëpërmjet:

- a. reduktimit të fushës së zbatimit të ligjit 12/2018, referuar analizave dhe statistikave të realizuara për jetësimin e rekomandimeve të GRECO-s,
- b. përcaktimit të një afati ligjor për kryerjen e procesit të vlerësimit,
- c. plotësimit të vakumeve ligjore,
- d. standardizimit dhe detajimit të procedurave të vlerësimit për të tre komponentët: pasuri, figurë dhe profesionalizëm,
- e. parashikimit të sanksioneve ligjore për t’i dhënë fuqi detyruese zbatimit të vendimit të trupave të vlerësimit nga institucionet përkatëse, etj.

*Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, ky projektligj synon rregullimin e disa procedurave dhe standardeve që lidhen me:*

1. Implementimin e rekomandimeve të GRECO-s, ku fokus kryesor është reduktimi i numrit të subjekteve që i nënshtrohen vlerësimit kalimtar, duke u përqendruar tek nivelet menaxheriale dhe strukturat me risk të lartë korrupsioni, me qëllim shmangien e pasigurisë juridike dhe mënjanimin e presionit të vazhdueshëm të punonjësit të organizatës për të rritur efektivitetin në mbarëvajtjen e punës. Funksionet e percaktura ne draft ndryshime, janë analizuar duke konkluduar në ato funksione me risk të madh korrupsioni, (për shkak të grupit të veprave penale që ndjekin, fushës së veprimtarisë dhe proceve të punës vendimmarrëse.
2. Saktësimin e terminologjisë dhe plotësimin e vakumit ligjor me qëllim shmangien e konfuzionit dhe keqinterpretimit të dispozitave të ligjit.
3. Rregullimin dhe standartizimin e procedurave të vlerësimit kalimtar për:
  - a) ndryshimin dhe rikonceptimin e procesit të vlerësimit të pasurisë në lidhje me përcaktimin e periudhës së vlerësimit (nga viti 2008 dhe në vijim) dhe rolin e ILDKPKI-së në funksion të këtij procesi;
  - b) qartësimin e objektit të kontrollit të figurës, saktësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe parshikimin e rolit të strukturës përgjegjëse të AMP-së mbi komponentin e figurës;
  - c) riformulimin e procedurës së aftësive profesionale duke rishikuar periudhën e vlerësimit, si dhe burimet nëpërmjet vlerësimit nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/ standardeve profesionale, ku në përfundim të shqyrtimit, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale.
4. Rikonceptimin e procesit të vlerësimit periodik me një frekuencë 5 vjeçare, për të gjithë ata punonjës brenda kategorisë së subjekteve që kalojnë më parë procesin e vlerësimit kalimtar.
  - a. Vlerësimi periodik konsiderohet i domosdoshëm për të sjellë një efekt të drejtëpërdrejtë parandalues për punonjësit objekt i këtij ligj (shef komisariati e lart), ku mundësia e abuzimit të detyrës gjatë ecurisë në karrierë është potencialisht më e madhe.
5. Përcaktimin e një afati fundor për procesin e vlerësimit mbi të tre komponentët e vlerësimit. Procesi i vlerësimit shtrihet në një afat kohor prej 180 ditë pune nga momenti i fillimit të hetimit kryesisht.
  - a. ILDKPKI, Struktura përgjegjëse pranë AMP-së dhe burimet njerëzore/standardet profesionale brenda 120 ditëve nga kërkesa e trupës së vlerësimit kanë detyrimin ligjor të paraqesin një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për komponentët përkatës.

- b. Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore ka detyrimin që, brenda 60 ditëve nga marrja në dorëzim të raportit nga struktura përkatëse, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë, të kryejnë hetime shtesë nëse gjykohen të nevojshme dhe të përfundojnë hetimin administrativ.
6. Përcaktimin e afatit ligjor të dorëzimit të deklaratave nga subjektet e deklaramit.
7. Rregullimin dhe përcaktimin e rasteve dhe pasojave të dorëheqjes së subjekteve gjatë procesit.
8. Parashikimin e “Barrës së Provës” si një element i hetimit administrativ.
9. Parashikimin e ndërprerjes së mandatit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit duke marrë shkas nga ecuria e procesit të vlerësimit e cila cënon parimin e sigurisë juridike dhe rrit koston financiare të procesit.
10. Detyrimin e institucioneve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës nëpërmjet një dispozite ligjore për zbatimin e vendimit të Trupave të Vlerësimit.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKË**

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është parashikuar në katër mujorin e dytë në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Nevoja për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 12/2018 ka ardhur si pasojë e:

1. Mospërmbushjes në kohë dhe efektive e qëllimit të këtij ligji për shkak të numrit të lartë të punonjësve që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit, rreth 12,000 punonjësve, ku përfundimi i procesit të vlerësimit kalimtar të krijonte një rreth vicioz, pa një afat fundor, duke krijuar pasiguri juridike dhe efekt negative ne organizatën e policisë, nisur kjo dhe nga trendi dhe ecuria e vlerësimit nga KJV.
2. Mospërcaktimit të qartë në ligj mbi periudhën për të cilën do të kryhet verifikimi i pasurive të deklaruara dhe periudhës për të cilën do të vlerësohen pasuritë e deklaruara.
3. Mosparashikimit të një afati fundor për procesin e vlerësimit mbi të tre komponentët duke sjellë një proces të tejzgjatur dhe joeficient që cenon besimin

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

e publikut.

4. Paqartësisë në parashikimet ligjore mbi kontrollin e figurës përsa i përket objektit, standardeve dhe rrethanave.
5. Subjektivizmit në vlerësimin e aftësive profesionale si pasojë e vlerësimit mbi tre punët më të mira të zgjedhura nga subjekti.
6. Mospërcaktimi i barrës së provës si element i hetimit administrativ.
7. Mosparashikimit në ligj të rasteve të dorëheqjes gjatë hetimit administrativ.
8. Mosparashikimit në ligj të detyrimit të institucioneve për zbatimin e vendimit.

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë rritjen e efektivitetit të procesit dhe përmbushjen e qëllimit të ligjit nëpërmjet realizimit të një procesi kontrolli dhe vlerësimi të bazuar tërësisht në ligj, duke plotësuar vakumet ligjore, me qëllim shmangien e keqinterpretimeve të ligjit në zbatimin praktik të tij.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në mbështetje të nenit 78 dhe 83, pika 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Ky projektligj përbëhet nga 51 nene, si më poshtë vijon:

**Në nenin 1**, të projektligjit, parashikohet që emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” të zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore”, togfjalëshi organi i/ organet e Vlerësimit zëvendësohet me trupa/trupat e vlerësimit, si dhe togfjalëshi “vetëvlerësim profesional” zëvendësohet me “vlerësim profesional”.

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

**Në nenin 2**, të projektligjit, parashikohen shtesa dhe ndryshime në nenin 3, si më poshtë vijon:

Shfuqizohet pika 1, pasi referuar shtrirjes së ligjit në kohë dhe hapësirë, personi nuk mund të paragjykohet pas 30 vitesh për një veprimtari të kryer në kuadër të ligjit të kohës.

Shfuqizimi i pikës 3 është bërë me arsyetimin se “dokument vlerësimit” është një term që nuk referohet në asnjë nen të Kreut V “Vlerësimi i aftësive profesionale”, po ashtu edhe shpjegimi i termit është i pasaktë, pasi “dokument vlerësimi” është çdo akt administrativ zyrtar që i nënshtrohet vlerësimit dhe jo domosdoshmërisht vetëm aktet e përgatitura nga vetë subjekti.

Shtohet pika 3.1 ku përkufizohet “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore” si institucioni përgjegjës për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Shtohet pika 3.2 ku është përkufizuar “ILDKPKI”-ja, në funksion të ndryshimit dhe rikonceptimit të vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI. Është materializuar në ligj roli i ILDKPKI-së, si organ i specializuar për të kryer vlerësimin e kriterit të pasuror.

Shtohet pika 3.3 ku përkufizohet “Informacion i klasifikuar”, duke u gjykuar si i nevojshëm për faktin se është një nga elementet e objektit të kontrollit të figurës.

Riformulimi i pikës 5 me qëllim qartësimin e konceptit të kontaktit të papërshtatshëm në harmoni me konceptimin e kreut IV për kontrollin e figurës.

Riformulimi i pikës 8 është parë i nevojshëm për të qenë në harmoni me përfundimin e raportit të kontrollit të figurës.

Riformulimi i pikës 13 ka rregulluar përkuzimin e referencës ligjore.

Riformulimi i pikës 23 të nenit përkufizon krimin e organizuar, si një element i objektit të kontrollit të figurës, referuar Kreut 4 “Kontrolli i figurës” dhe i referohet vetëm gamës së veprave penale të përcaktuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Riformulimi i pikës 24 të nenit përkufizon procesin e vlerësimit në mënyrë më të kuptueshme.

**Në nenin 3**, të projektligjit, parashikohet shtimi i nenit 3/1 dhe 3/2 të ligjit që pasqyron përkatësisht parimet themelore mbi të cilat bazohet procesi i vlerësimit dhe parashikimin e të drejtës së informimit dhe rastet e kufizimit të saj. Ky nen është parashikuar të shtohet si një garanci juridike.

**Në nenin 4** të projektligjit parashikohet shfuqizimi i pikës 2 dhe 3 të nenit 4 pika të cilat janë reflektuar si nene më vete për shkak të rëndësisë që kanë për procesin.

**Në neni 5** të projektligjit parashikohen të bëhen ndryshime në emërtimin dhe pikat 1, 3, 4, 6 dhe 7 të nenit 5, për të qenë në koherencë me përfundimin e ushtrimit të funksionit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

**Në nenin 6**, të projektligjit, parashikohen ndryshime dhe riformulim i nenit 6 në lidhje me reduktimin e numrit të subjekteve që i nënshtrohen vlerësimit kalimtar, duke u përqendruar tek nivelet menaxheriale dhe strukturat me risk të lartë korrupsioni, me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit të vlerësimit, përmbushjen e qëllimit të ligjit 12/2018 dhe shmangien e pasigurisë juridike.

Gjithashtu, parashikohet detyrimi i subjekteve për të plotësuar dhe dorëzuar formularët e deklarimit të pasurisë me udhër të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Inspektorit të Përgjithshëm, ndërsa për formularin e figurës dhe profesionalizmit me urdhër të Ministrit të Brendshëm

**Në nenin 7**, të projektligjit, parashikohet riemërtimi i Kreut II dhe i Seksionit I, për të qenë në koherencë me ndryshimet e propozuara në tërësi mbi ndërprerjen e veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

**Në nenin 8**, të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i neneve 7, 8 dhe 9, si rezultat i përfundimit të veprimtarisë së KJV.

**Në nenin 9**, të projektligjit, parashikohet që të bëhen disa ndryshime në nenin 10 për sa i përket kriterëve të përzgjedhjes së anëtarëve të trupave të vlerësimit pranë AMP-së, si institucioni i vetëm që do të kryej procesin e vlerësimit kalimtar/periodik.

**Në nenin 10**, të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i neneve 11, 12 dhe 13, si rezultat i parashikimit të përfundimit të ushtrimit të veprimtarisë së KJV-së.

**Në nenin 11**, të projektligjit, parashikohet ndryshimi i emërtimit të Seksionit IV, për arsyet e përmenduara më lart.

**Në nenin 12**, të projektligjit, parashikohen që të bëhen disa ndryshime dhe shtesa në nenin 24 në lidhje me Drejtuesin e trupave të Vlerësimit dhe kompetencave të tij.

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Këto ndryshime janë bërë për të qenë në harmoni me të gjitha ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, përsa i përket përfundimit të ushtrimit të funksionit të KJV-së dhe marrjen e të gjitha kompetencave nga ana e trupave të vlerësimit dhe Drejtuesit të tyre pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

**Në nenin 13**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 25 të shfuqizohet shkronja d e pikës 1.

**Në nenin 14**, të projektligjit, parashikohet që të shfuqizohet neni 26.

**Në nenin 15**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 27 të bëhen disa zëvendësime të emërtimeve nga “Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit” në “Trupave të Vlerësimit”, nga “të kryetarit ose të organeve kompetente” në “të drejtuesit të strukturës”, dhe nga “marrjen e detyrës” në “pranimin e dosjes së subjektit nga ana e:”, si dhe riformulim i pikës 2.

**Në nenin 16**, të projektligjit, parashikohen disa ndryshime dhe shfuqizime në pikat e nenit 28 mbi procedurat për përjashtimin e anëtarëve të Trupave të Vlerësimit të AMP-së.

**Në nenin 17**, të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i neneve 29 dhe 30, pasi flitet për trajtimin financiar dhe mbështetjen logjistike të KJV-së, i cili do shkrihet.

**Në nenin 18**, të projektligjit, parashikohet ndryshimi dhe riformulimi i pikës 1 të nenit 32 dhe shtimi i një pikë të re numër 2 në lidhje me kufizimin kohor të shtrirjes së vlerësimit të pasurisë, nga një afat pa limit, në një afat të përcaktuar që fillon nga viti 2008 e në vazhdimësi. Ky parashikim është parë i nevojshëm si rezultat i formalizimit të ekonomisë, parashikimit të legjislacionit në fuqi për ruajtjen/arkivimin e dokumentacionit nga institucionet publike, si dhe të dhënave sistematike të INSTAT.

Gjithashtu, në pikën 3 të nenit 32 është parashikuar penalteti për subjektet që nuk dorëzojnë në kohë formularët e deklarimit.

**Në nenin 19**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 33 të riformulohet duke grupuar zërat e deklarimit të bazuar sipas formularëve të deklarimit si dhe të shtohen pikat 3,4 dhe 5, referuar qasjes së re mbi rolin dhe funksionin e ILDKPKI-së në këtë proces vlerësimi, janë importuar disa koncepte procedurale dhe dispozita të nevojshme për të shpjeguar dhe plotësuar procesin.

**Në nenin 20**, të projektligjit, parashikohet që të shtohet neni 33/1, ku sipas ndryshimit të propozuar, futja në rol e ILDKPKI-së është një garanci e shtuar në këtë proces kompleks, qoftë në kuptimin e paanësisë ashtu edhe profesionalizmit,

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

por edhe në drejtim të rritjes së besueshmërisë në këtë proces dhe minimizimit të paragjyqimeve reale apo potenciale.

Referuar qasjes së re dhe ndryshimeve të propozuara mbi procesin e vlerësimit të pasurisë, në këtë nen pasqyrohet procedura e vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI, në mënyrë të ngjashme me rolin e saj në rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, përcaktimi i afatit prej 120 ditëve brenda të cilit duhet të kryhet procesi i vlerësimit nga ILDKPKI, është gjykuar i nevojshëm për të siguruar një proces të rregullt dhe efikas.

**Në nenin 21**, të projektligjit, parashikohen disa shtesa dhe ndryshime në nenin 34, si më poshtë vijon:

- Të shfuqizohet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”;
- Të ndryshohet pika 3 në lidhje me vënien në dispozicion të një raporti të hollësishëm nga ILDKPKI-ja, si një garanci e shtuar në këtë proces, dhe të rinumërohet si pikë 1.
- Të shtohet pika 3.1 ku përcaktimi i një afati është i nevojshëm për të siguruar një proces më të drejtë dhe real duke krijuar siguri juridike për subjektet;
- Të shfuqizohet pika 4 e nenit 34.
- Në shkronjën “b”, të pikës 6 të hiqet togfjalëshi “kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”.

**Në nenin 22**, të projektligjit, parashikohet që të riformulohet neni 35 si rezultat i faktit se procedura e kontrollit të figurës do shtrihet edhe te personi i dyshuar, jo vetëm tek personi i proceduar apo dënuar.

**Në nenin 23**, të projektligjit, parashikohet që në shkronjën “dh”, të pikës 3 të nenit 36, emërtimi “Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” zëvendësohet me emërtimin “Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, si një burim i shtuar që do t’i shërbejë procesit të kontrollit të figurës.

**Në nenin 24**, të projektligjit, parashikohet që të riformulohet pika 1 e nenit 37 dhe të shfuqizohen pikat 2 dhe 3 të tij, për të qartësuar dhe për të qenë në harmoni me terminologjinë e përdorur në procesin e kontrollit të figurës.

**Në nenin 25**, të projektligjit, parashikohen disa ndryshime dhe riformulim drejtshkrimor të nenit 38 mbi verifikim e rrethanave për kontrollin e figurës. Është parashikuar shfuqizimi i pikës “g” të nenit, pasi referuar shtrirjes së ligjit në kohë dhe hapësirë, personi nuk mund të gjykohej pas 30 vitesh për një veprimtari të kryer sipas ligjit të kohës.

Këtu përcaktohet nënshtrimi i subjektit ndaj testit për përdorim lëndësh narkotike, si rrethanë me rëndësi të veçantë.

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.



**Në nenin 26**, të projektligjit, parashikohet që të riformulohet pika 1 e nenit 39, si rezultat i nevojës për të përcaktuar gamën e informacioneve të cilat do të administrohen dhe vlerësohen nga trupat e vlerësimit, pasi kontrolli i figurës nuk bazohet vetëm në prova, por edhe në informacione e të dhëna.

**Në nenin 27**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 40 të shfuqizohet shkronja “a” pasi nuk mund të gjejë zbatim si një rrethanë rënduese, si dhe të shtohen shkronjat “c” dhe “ç” pasi janë rrethana që rëndojnë pozitën e subjektit të vlerësimit, të pasqyruara në nene të vecanta të Kreut IV.

**Në nenin 28**, të projektligjit, parashikohet riformulimi i nenit 42 mbi procedurën e kontrollit të figurës, për të qenë në koherencë me përfundimin e raportit si person i përshtatshëm ose i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, si edhe përcaktimi i një afati të nevojshëm për të siguruar një proces më të drejtë dhe real duke krijuar siguri juridike për subjektet.

**Në nenin 29**, të projektligjit, parashikohet që në pikën 1 të nenit 44 të shtohet togfjalëshi “urdhër të Ministrit të Brendshëm, ose në momentin e emërimit në funksionet objekt vlerësimi”, si dhe në pikën 2 dhe 3 të këtij neni “7 vjet” të zëvendësohet me “5 vjet”.

**Në nenin 30**, të projektligjit, parashikohet që të bëhen disa ndryshime dhe riformulime në nenin 45 si rezultat i subjektivizmit në vlerësimin e aftësive profesionale që vijnë si pasojë e vlerësimit mbi tre punët më të mira të zgjedhura nga vetë subjekti, si edhe shfuqizimi i pikës 3 që bie në kundërshtim me titullin e nenit që flet për burime të vlerësimit, ndërkohë që pika 3 i referohej objektit të vlerësimit.

**Në nenin 31**, të projektligjit, parashikohet që të shfuqizohen pikat 3 dhe 5 të nenit 46, si dhe të riformulohet pika 2 e tij, pasi referuar qasjes së re, ku për t’iu përgjigjur ndryshimeve të propozuara për kriterin e profesionalizmit, strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore/ standarteve profesionale të institucioneve përkatëse do të përgatisin një raport performace për t’ia rekomanduar trupave të vlerësimit.

Rol aktiv ka vetë struktura ku bën pjesë subjekti, e cila do të përgatisë një raport të hollësishëm brenda 120 ditëve për t’u vlerësuar nga trupa e vlerësimit, duke hequr dorë në këtë mënyrë nga paraqitja e dokumentave që dorëzonte subjekti dhe duke minimizuar apo keqpërdorur aftësinë e trupës për të vlerësuar një punonjës që nuk është pjesë e institucionit.

**Në nenin 32**, të projektligjit, parashikohet që të riformulohet neni 47. Ky ndryshim bëhet për të qenë në sinkron me parashikimet e propozuara për procesin e vlerësimit

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

të aftësive profesionale. Gjithashtu është përcakuar një afat i nevojshëm (prej 60 ditësh, me të drejtë shtyerje deri në 30 ditë) për të siguruar një proces më të drejtë dhe real duke krijuar siguri juridike për subjektet.

**Në nenin 33**, të projektligjit, parashikohet shtimi i një neni të ri 47/1 që pasqyron paanshmërinë dhe pavarësinë në vendimarrjen e trupave të vlerësimit pranë AMP-së.

**Në nenin 34**, të projektligjit, parashikohet që në pikën 3 të nenit 51, pas fjalës “vlerësojnë” shtohet togfjalëshi “dhe vërtetojnë”.

**Në nenin 35**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 52 të hiqen disa togfjalësh që nuk gjejnë zbatim në këtë ligj.

**Në nenin 36**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 53 pas fjalës “informacionet” të shtohet togfjalëshi të “vërtetuara në mënyrë ligjore”.

**Në nenin 37**, të projektligjit, parashikohet që të shtohet neni 53/1 me emërtim “Barra e provës”, si një element i rëndësishëm i një procesi hetimi administrativ.

**Në nenin 38**, të projektligjit, parashikohet që të shfuqizohet pika 3 e nenit 54, pasi organet Komisioni Qendror dhe Vendor i Vlerësimit janë shfuqizuar me ndryshimet e ligjit 2019, si dhe të riformulohet pika 2 e tij.

**Në nenin 39**, të projektligjit, parashikohet që nenin 55 të zëvendësohet fjala “organi” me “institucioni”, si dhe togfjalëshi “Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit” me “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore”.

**Në nenin 40**, të projektligjit, parashikohet që në të shfuqizohet në pikat 1, 4, 5 dhe 6 të nenit 56 emërtimi “ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

**Në nenin 41**, të projektligjit, parashikohet riformulimi i nenit 57 duke qenë se dorëheqja është një akt vullneti dhe mund të formalizohet në çdo moment të hetimit administrativ, parë kjo dhe në harmoni me ndryshimet e vitit 2020 të nenit 49 të ligjit “Për policinë e Shtetit”, gjykohet e nevojshme përfundimi i procesit pa një vendim përfundimtar, si rrjedhojë e faktit se punonjësi i dorëhequr nuk është më subjekt i këtij ligji. Gjithashtu, procesi i dorëheqjes është një e drejtë kushtetuese, por edhe e materializuar në kontratën individuale të punës, apo në aktet ligjore që normojnë këtë marrëdhënie.

**Në nenin 42**, të projektligjit, parashikohet që në pikën 3 të nenit 58 të riformulohet shkronja “b” “trupën e vlerësimit, që ka shqyrtuar çështjen;”.

**Në nenin 43**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 59 të hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, të shfuqizohen shkronjat “b” dhe “c”, si dhe të shtohet një pikë mbi rekomandimin drejtuar titullarit të institucionit për të larguar punonjësën nga kategoria e pozicioneve objekt vlerësimi.

**Në nenin 44**, të projektligjit, parashikohet që në pikën 2 të nenit 60 hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

**Në nenin 45**, të projektligjit, parashikohet që të shfuqizohet neni 61 “Detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit”, për të qenë në harmoni me ndryshimet e propozuar në kreun V të vlerësimit të aftësive profesionale. Ky shfuqizim është gjykuar i nevojshëm për të shmangur subjektivizëm nga trupat e vlerësimit.

**Në nenin 46**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 62 të hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, të riformulohet shkronja “d” për të qenë në harmoni me pikën 2 të nenit 42 mbi kontrollin e figurës, si dhe të shfuqizohen shkronjat “a” dhe “dh”.

**Në nenin 47**, të projektligjit, parashikohet që të shtohet neni 62/1 “Detyrimi i institucionit për zbatimin e vendimit”. Shtimi i këtij neni është parë i nevojshëm për t’i dhënë fuqi detyruese zbatimit të vendimit të trupave të vlerësimit nga institucionet përkatëse.

**Në nenin 48**, të projektligjit, parashikohet që neni 64 të riemërtohet, të shfuqizohet pika 2, si dhe të zëvendësohet togfjalëshi “Anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sekretariateve teknike pranë tyre” me togfjalëshin “Anëtarët e Trupave të Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

**Në nenin 49**, të projektligjit, parashikohet që të riformulohet neni 65 “Vlerësimi periodik”.

Është gjykuar që vlerësimi periodik të bëhet me një frekuencë 5 vjeçare, për të gjithë ata punonjës brenda kategorisë apo fashës së subjekteve që kalojnë më parë procesin e vlerësimit kalimtar. Ky proces do të vlerësojë vetëm ndryshimet e ndodhura në të tre komponentët gjatë periudhës nga vlerësimi kalimtar. Objekti, parimet, procedura dhe vendimmarrja për vlerësimin periodik në kriterin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale është e njëjtë me atë të vlerësimit kalimtar.

**Në nenin 50**, të projektligjit, parashikohet që në nenin 66 të shfuqizohet pika 1 dhe të riformulohet pika 2 dhe shtohet pika 3 që ngarkon ministrin përgjegjës për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Në **nenin 51**, të projektligjit, parashikohet që të riformulohet neni 68 i dispozitave kalimtare, duke parashikuar ndërprerjen e mandatit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit duke marrë shkas nga ecuria e procesit të vlerësimit e cila çënon parimin e sigurisë juridike dhe rrit koston financiare të procesit. Gjithashtu është parashikuar afati për plotësimin e formularëve nga subjektet e përcaktuar në nenin 6 të ligjit, si dhe administrimi i formularëve të deklarimeve të plotësura më parë nga strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore të çdo institucioni.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Ky projektligj është hartuar nga grupet e punës të krijuara me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

Gjithashtu ky projektligj është konsultuar me ILDKPKI, ku në vijim paraqesim mendimet dhe sugjerimet e tyre dhe komentet e Ministrisë së Brendshme:

**1.Komenti i ILDKPKI-së:** Në lidhje me nenin 6 pika 2 në të cilin parashikohet se: *“Subjektet e vlerësimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kanë detyrimin të plotësojnë dhe të dorëzojnë formularët e deklarimit të miratuara me udhëzim të Ministrisë së Brendshme, dhe Inspektorit të Përgjithshëm të ILDPKI –së brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit”*, rekomandohet:

Në të gjithë tekstin e projekt-ligjit duhet të bëhet zëvendësimi i shkurtimit “ILDPKI” me akronimin “ILDKPKI”. Formularët e deklarimit duhet të miratohen me akt nënligjor në formën e “Urdhrit” të Ministrit të Brendshëm, si institucion që ka në varësi të drejtpërdrejtë Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, e ngarkuar për kryerjen e vlerësimit kalimtar dhe periodik të subjekteve të këtij projekt-ligji. Udhëzimi në formën e një akti nënligjor përcakton rregullat, apo procedurat që duhet të ndiqen me qëllim plotësimin e formularit të deklarimit, i cili në formë dhe përmbajtje miratohet me urdhër.

Gjithashtu, miratimi i formularëve të deklarimit për procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik nuk mund të miratohen së bashku nga Ministri i Brendshëm dhe ILDKPKI, për aq sa ky i fundit nuk është përgjegjës, por vetëm ndihmës i trupave

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

të vlerësimit të parashikuar nga projekt-ligji. Në këtë kuadër, ILDKPKI mund të japë konsulencë për të dhënë rekomandime apo sugjerime për formularin që do të hartohet dhe miratohet nga Ministria e Brendshme.

**1.Koment Ministria e Brendshme:** Lidhur me sugjerimin dhe komentin tuaj mbi llojin e aktit të miratimit të formularëve të deklarimit dhe zëvendësimin e shkurtimit “ILDPKI” me akronimin “ILDKPKI”, shprehim dakordësinë tonë dhe reflektohet në projektligj. Sa i përket formularave e deklarimit për kriterin pasuror gjykojmë që duhet të miratohen me Urdhër të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Inspektorit të Përgjithshëm, pasi ILDKPKI do ketë rol aktiv në vlerësimin e këtij kriteri, dhe elementi thelbësor i vlerësimit është formulari i deklarimit, që ka të bëjë me mënyrën e plotësimit, llojin e të dhenave që do pasqyrohen, si dhe rubrikat e domosdoshme, me qëllim kryqëzimin me gjetjet e korespondencat e institucioneve.

**2.Komenti i ILDKPKI-së:** Në lidhje me nenin 32 “Fillimi i procedurës për deklarimin e pasurisë” në të cilin parashikohet se: *“1.Punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga momenti i fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policorederi në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë. 2.Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim.3.Punonjësi plotëson deklaratën e pasurisë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1, të këtij neni, brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e udhëzimit të inistrit të Brendshëm dhe Inspektorit të Përgjithshëm të ILDPKI –së, ose në momentin e emërimit në funksionet objekt vlerësimi dhe e dorëzon në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon.4. Nëse punonjësi nuk dorëzon deklaratën e pasurisë, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, ai largohet nga pozicionet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji. 5.Njësia e burimeve njerëzore e vendos deklaratën e pasurisë në dosjen përkatëse, të çelur për punonjësin, dhe e dërgon në trupën përkatëse të vlerësimit.6.Punonjësi mund të paraqesë të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive. Paraqitja e plotë e dokumenteve, që vërtetojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, vlerësohet bashkë me rrethanat e tjera për marrjen e vendimit të vlerësimit”* rekomandojmë:

✚ Me qëllim unifikimin e termave të përdorur, duhet të bëhet zëvendësimi i “punonjës” me termin “subjekt vlerësimi”, për aq sa në nenin 3 të projekt-ligjit ky term përfshin punonjësit që do ti nënshtrohen procesit të vlerësimit.

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

- ✚ Shprehja “moment i fillimit të punës” duhet të zëvendësohet me “datën e fillimit të punës” për aq sa është lehtësisht e përcaktueshme në urdhrin e fillimit të marrëdhënieve të punësimit.
- ✚ Pika 1 e nenit 32, duhet të ndryshohet si vijon. Subjekti i vlerësimit deklaron të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë dhe interesave private, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga subjekti i vlerësimit, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë.
- ✚ Pika 2 e nenit 32, duhet të ndryshohet duke u hequr kufizimi “**nga viti 2008 dhe në vijim**” për aq sa bie në kundërshtim me vet objektin e vlerësimit të pasurisë, i cili kërkon ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të deklaruar në formularin e deklarimit.

Vendosja e kufizimit kohor nuk mundëson kryerjen e një kontrolli të plotë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke penguar hetimin e ligjshmërisë të pasurive të krijuara përpara vitit 2008. Nëse një pasuri është krijuar në vitin 2007, subjekti përjashtohet nga detyrimi për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, çka është në kundërshtim me vet objektin e vlerësimit të pasurisë, i cili kërkon vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private, burimit financiar të krijimit të pasurive dhe ligjshmërinë e tij.

Për më tepër, ILDKPKI, në përmbushje të detyrimeve funksionale dhe kompetencave ligjore, në praktikën e gjatë 19 vjeçare, kryen kontrollin e pasurisë së subjekteve deklarues, bazuar në ligjin “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, që kërkon një hetim të plotë mbi ligjshmërinë e pasurive të deklaruara. Kështu, ILDKPKI ka pasur praktika të suksesshme me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, si dhe me kandidatët për institucionet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, të cilët për këto procese të rëndësishme kanë plotësuar deklaratat për kandidatë dhe i janë nënshtruar procedurave të kontrollit. Në përfundim ILDKPKI ka kryer kontroll të plotë gjithëpërfshirës duke analizuar pasurinë dhe ligjshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj dhe jo duke e ndarë në periudha kohore.

- ✚ Pika 3, duhet të ndryshohet në përputhje me rekomandimin e dhënë për nenin 6 pika 2, si në formën e aktit nënligjor me anë të të cilit duhet të miratohet formulari i deklaramit, ashtu dhe me institucionin përgjegjës që duhet të nxjerrë këtë akt.
- ✚ Pika 6, duhet të hiqen termat “mundet” për atë sa paraqitja e dokumentave justifikues për vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramive janë të domosdoshme dhe thelbësore për fillimin dhe ecurinë e procesit të vlerësimit të pasurisë.

## **2. Koment Ministria e Brendshme:**

- ❖ Lidhur me komentet e sipërcituara, janë reflektuar sugjerimet sa i përket zëvendësimit të fjalës “punonjës” me termin “subjekt vlerësimi”, si dhe zëvendësimi i “moment i fillimit të punës” me “datën e fillimit të punës”, me qëllim unifikimin e termave të përdorur.
- ❖ Gjithashtu, është reflektuar dhe zëvendësimi i termit “mundet” me “duhet” në pikën 6 të nenit 32, duke qenë se paraqitja e dokumentave justifikues për vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramive janë thelbësore për verifikimin dhe vlerësimin e pasurisë.
- ❖ Në lidhje me sugjerimit tuaj për të hequr kufizimin “**nga viti 2008 dhe në vijim**”, në pikën 2 të nenit 32, grupi hartues i punës, pas një analize të thellë dhe të arsyetuar ka gjykuar si të domosdoshme rikonceptimin e procesit të vlerësimit të pasurisë, duke përcaktuar deklaramin e subjektit pa afat kohor, ndërsa periudhën e vlerësimit nga viti 2008 dhe në vijim, pasi kjo periudhë përkon me formalizimin e ekonomisë, parashikimin e legjislacionit në fuqi për ruajtjen/arkivimin e dokumentacionit nga institucionet publike, si dhe të dhënave sistematike të INSTAT, duke mundësuar kështu lehtësi në aksesimin e të gjitha dokumentave që justifikojnë vërtetësinë e deklaramive për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive.
- ❖ Në analizë janë trajtuar dhe vendimarrjet dhe ecuria e procesit nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, i cili ka hasur vështirësi mjaft serioze për mbledhjen e dokumentacionit, duke pasqyruar vendimmarrje të paqarta interpretative dhe standarde ndryshe, kjo thjesht dhe vetëm nga mos kufizimi i afatit kohor dhe mungesa e dokumentacionit justifikues.
- ❖ Arsyetojmë gjithashtu që kufizimi kohor, nuk nuk bie ndesh me ligjin organik të **ILDKPKI-së**, pasi nuk është elementi kohë që cënon standardin, por metodologjia, procedura dhe vendimarrja, që në këtë projekt ligj janë të njëjta. Ligji 12/2018 përkatësisht nenet 32, 33, 34 janë të sinkronizuara me ligjin nr.9049, dt.10.04.2003 “*Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare....*”, nenet 4, 4/1, 4/2, 21, 22, 25, 26 dhe në vijim,

madje dhe me ligjin për rivlerësimin e prokurorë/gjyqtarëve, ku ILDKPKI-së ka të njëjtin rol, që duam ti japim me këtë projekt ligj, pa asnjë ndryshim.

Ne vlerësojmë eksperiencën e ILDPKPI, lidhur me praktikat e suksesshme për rivlerësimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, por theksojmë se inicimi dhe fryma e këtij ligji, nuk është e barasvlefshme me ligjin e rivlerësimit kalimtar të prokurorë/gjyqtarëve, pasi dhe interesi publik, është proporcionalisht më i madh për këta të fundit, në kuadër të reformës në drejtësi. Ligji 12/2018, është një ligj me efekt të përkohëshëm, i cili nuk ka qëllim primar ndëshkimin e funksionarëve të policisë, por identifikimin e pjesës së shëndoshë dhe me integritet të cilët duhet të vlerësohen gjatë ecurisë në karrierë.

Si përfundim, për ta mbyllur arsyetimin e vendosjes së afatit afatit kohor. I gjithë ky proces, lidhur me vlerësimin pasuror, do definojë në vendimmarrje, dhe nuk do jetë deklarativ, për rrjedhojë, vendosja një afati të përcaktuar formalizues, të drejtë dhe objektiv, do garantojë procesin e rregullt ligjor, respektimin kontradiktoritetit, dhe garantimin e të drejtave të subjekteve.

**3.Komenti i ILDKPKI-së** Në lidhje me nenin 33 “Deklarimi i pasurisë”, rekomandojmë që të ndryshohet në tërësinë e tij me qëllim përshtatjen me kuadrin ligjor për deklarimin e interesave privatë dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

**3.Koment Ministria e Brendshme:** Lidhur me këto sugjerime mbi nenin 33 “Deklarimi i pasurisë” janë reflektuar pjesëshëm rekomandimet për të përshtatur deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë të subjektit dhe personave të lidhur me të, me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, pra janë ndërthurur elementë të propozimeve të ILDKPKI-së me nenin ekzistues.

**4.Komenti i ILDKPKI-së:** Në lidhje me nenin 33/1, në të cilin parashikohet “Procedura e vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI”, duhet të shfuqizohet në tërësi, për aq sa në këtë proces Inspektorati i Lartë është organ ndihmës i trupave të vlerësimit të cilat do të krijohen pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, me fuqi vendimmarrëse.

Projekt ligji parashikon që subjektet e vlerësimit do t’i nënshtrohen vlerësimit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, procese të cilat do të asistohen nga institucione të tjera qendrore në ndihmë të trupave të vlerësimit. Për institucionet e tjera ndihmëse nuk është parashikuar një dispozitë e veçantë për procedurën që do të ndjekin për asistimin e këtij procesi, për aq sa kjo duhet t’i lihet trupës së



vlerësimit për të hartuar dhe miratuar aktet nënligjore mbi rregullimin e procesit të vlerësimit në tërësi.

Kjo vjen në vazhden e të gjitha proceseve të ngjashme të kryera nga ILDKPKI për verifikimin e pasurisë së kandidatëve për në organet e sistemit të drejtësisë, ku organet e emërtesës, kanë nxjerrë aktet nënligjore për rregullimin e të gjithë procedurës së vlerësimit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale.

**4.Koment Ministria e Brendshme:** Lidhur me këtë koment janë reflektuar sugjerimet sa i përket procedurës së vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI, duke riformuluar pikën 1 dhe 2 të nenit 33/1, por duke mos hequr shkronjën “dh” dhe pikën 4 të këtij neni si të domosdoshme për konkluzionet e raportit, që passjellin dhe vendimarrje me të drejtë dhe objektive.

Projektligji është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Ministrisë së Drejtësisë.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI**

**BLEDAR ÇUÇI**